1 (nje) Projektues Instalator (Licensa 4 a,b,c,f,j: për projektim të instalimeve hidro-termosanitare, Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme; Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale; Projektim të sistemeve

kundra zjarrit; Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.

Stafi i sipërcituar është staf mbështetës për përgatitjen e projektit të zbatimit (Faza V-VI).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projekte të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Për secilin punonjës te paraqitet diploma, kontrata e punes dhe CV.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specififikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

ARGUMENTIMI I STAFIT

Inxhinier Ndërtimi	- Punime te lirimit te sheshit te ndertimit - Punime germimi, hidroizolimi dhe nenshtresash - Punime betoni - Punime murature - Punime shtresash - Punime ne fasade, tavani, suvatimi dhe veshje - Punime vetrata dhe dyer - Punime bojatisje - Punime te tarraces - Punime te ndryshme - Punime shtresash trotuari dhe bordure betoni
Inxhinier Hidroteknik	- Rrjeti i shperndarjes se ujit sanitar dhe pajisjet - Ambienti teknik - Makineri dhe pajise per sistemin e furnizimit me uje

	- Sistemi i shkarkimeve te ujrave te zeza dhe te shiut - Kollonat e shkarkimit te shiut - Shkarkimi i rrjetit te jashtem te ujrave te shiut - Shkarkimi i rrjetit te jashtem te ujrave te zeza - Pajisjet e shkarkimit te ujra te zeza dhe te bardha - Sistemi i kondicionimit - Sistemi VRF - Rjeti I tubove te kondensatit - Tubo PP - Instalimet e sistemit te ajrit - Pajisjet per Sistemin e Kondicionimit - Sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit - Ambienti teknik I impiantit te mbrojtjes nga zjarri - Makineri dhe pajisjet per sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit - Punime te ashensorit - pajisje
Inxhinier Mekanik	- Sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit - F.V Tabela drejtim dalje - F.V Tabela hidranti - F.V Tabela Zbritje shkallësh - F.V Tabela buton alarmi - F.V Tabele fikse zjarri me pluhur - F.V Tabele fikse zjarri me karrel - F.V Tabele lidhje me motopopmen - F.V Tabele ndalim I shurajes me uje - F.V Tabele rrezik tensioni I larte - Sistemi VRF - Rjeti I tubove te kondensatit - Instalimet e sistemit te ajrit - Pajisjet per Sistemin e Kondicionimit - Sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit - Ambienti teknik I impiantit te mbrojtjes nga zjarri - Makineri dhe pajisjet per sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit - Ulluiqet e shkarkimeve horizontale dhe vertikale
Inxhinier Mjedisi	- Punime te lirimit te sheshit te ndertimit - F Transport dheu me auto deri ne 10 km - Punime germimi, hidroizolimi dhe nenshtresash - Punimet e gjelberimit - Punime dheu dhe mbushjeje - punime shtrimi ne ambientet e jashtme etj.
Inxhinier Elektrik	- Instalimet e ndricimit - Instalimet e fuqise - Sistem data telefon - Instalimet e sistemit te alarmit te zjarrit - Instalimet e sistemit cctv - Instalimet e sistemit te ndricimit emergjent - Punime per ndricimin ne pjesen e jashtme
Inxhinier Gjeodet	Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë prezencën në objekt të personelit të mesiperm dhe/ose te kërkojë ndryshimin/zevendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose me të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave perkatese. Në rast perseritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mesipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e perkohshëm ose të levizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikeqyrjes. Operatori/et ekonomik/e, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat perkatese lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimin të mjedisit, për rastet ndotjesh sic; parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakesimin e rrezeqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësive të jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat perkatese të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë rekomandohet të jete në kantier për minimizimin e aksidenteve në punë.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punetore prej **minimalisht 34 persona** për periudhën 3 muajore nga momenti i hapjes së ofertave e vertetuar kjo me:

- Vertetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 muajore nga momenti i hapjes së

ofertave.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. _Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39 pika 6/ç të VKM nr.285/2021 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar. Ne percaktimin e numrit të punonjesve është bërë një analizë bazuar tek faktoret, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjesve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjesve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me koheshtrirje (3 muajë nga momenti i hapjes, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjesve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listat me këto koheshtrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç; besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjesve. Vendosja e kriterit duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka rreth funksionit të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të cmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" Bazuar në këto elemente të strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport) zëri i fuqisë punëtore është rreth 20% të kostos.

Total ore punë= 71,867.27 ore

Ore/1 ditë punë= 8 ore

Total Ditë punë punëtori= 71,867.27 ore/8 ore= 8,983.41 ditë punë

Ditë punë gjithsej= 12 muaj (sipas grafikut të punimeve) * 22 ditë/muaj= 264 ditë punë

Numri i fuqisë punëtore = 8,983.41 ditë/264 ditë= 24.92 punëtorë afërsisht **34.02 punëtorë**

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë punëtore që kërkohej për realizimin e punimeve është min **34.02 punëtorë. Pranojmë 34 punëtorë**

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme në pronësi ose qira ose kontratë furnizimi

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasia	Statusi
1	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
2	Ekskavator me goma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
3	Kamioncine deri ne 6 tone	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
4	Minieskavatore	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
5	Fadrome me kove para dhe mbrapa	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
6	Autobot uji	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
7	Autobetoniere	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
8	Auto-Pompe betoni	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
9	Mjet Autovinç	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
10	Kompresor	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
11	Matrapik	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
12	Skeleri	m ²	1500	Ne pronesi ose me qera
13	Gjenerator	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
14	Elektrosaldatriçe	Copë	2	Ne pronesi ose me qera

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara ne asnje kontrate tjeter publike, qe bie ndesh me legjislacionin e fushes se ndertimit, dhe do te angazhohet vetem per realizimin e ketij objekti.

Si deshmi per te vertetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do te paraqiten keto dokumenta:

- Për mjetet ne pronesi (që shënohen në regjistra publikë), duhet të paraqiten;- dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), -plus certifikaten e kontrollit teknik, -siguracionin e mjetit (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore.
- Për mjetet e siguruar me qira, duhet të paraqiten; -dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore, kontrata e qirase e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit._Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik si me siper ose te kerkoje operatorit sqarime dhe dokumente mbeshtetese per keto sqarime ne perputhje me nenin 24 pika 1 te VKM nr.28 date 19.05.2021 per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik.

Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c; dhe 6/d, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane fuqine minimale punetore, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten.

Per te percaktuar numrin e mjeteve/makinerive te nevojshme per realizimin e kontrates, jane hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit te fushes bazuar ne VKM nr. 629, date 15.7.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, date 26.10.2018)

ARGUMENTIMI MJETET

Mjetet	Proceset e punes
Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton	Transport materiale ndertimi, dheu me auto
Ekskavator me goma	Germim themele e plinta b~2m, ekskavator me goma, kova 0.25m3 shkarkim auto
Kamioncine deri ne 6 tone	Furnizim me materiale ne objekt
Minieskavatore	Punime per shtresa cakulli (Sistemime)
Fadrome me kove para dhe mbrapa	Transport materialesh brenda kantjerit
Autobot uji	Furnizimin me uje per pergatitjen e materialeve lidhese ne objekt, Sperkatjen me uje te punimeve gjate ndertimit dhe eleminimin e pluhurave
Autobetoniere	Punime betoni e betonarmeje
Auto-Pompe betoni	Punime betoni e betonarmeje
Mjet Autovinç	Montime te ndryshme ne objekt
Kompresor	Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik
Matrapik	Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik
Skeleri	Skele metalike me tubo tavani ~ 4m Skele metalike me tubo fasade > 12m
Gjenerator	Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik
Elektrosaldatrice	Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik

2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit te cilesise) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise
- EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit te mjedisit) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise

- ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shendetit dhe sigurise ne pune) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të leshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vertetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër; ose ti kerkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për keto sqarime në përputhje me nenin 24 pika 1 të VKM nr.28 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilesise dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Për vet natyrën e vecante, vendndodhjes dhe permasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kerkuara të cilesise. Sistemi i menaxhimit të cilesie, mjedisit dhe shendetit dhe sigurise në punë janë standarte që cdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Keto certifikata lidhen ngushtesisht me objektin e kontratës përsa kohe do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatoreve ekonomike dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plate të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kerkojë certifikata, të leshuara nga organe të pavarura, që vertetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kerkuara të cilesise, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shendetit dhe sigurise në punë.

-Projekti i zbatimit, Specifikimet teknike, raportet teknik, preventivi me zërat e punimeve, grafiku i punimeve janë hartuar nga projektues i licencuar dhe janë pjesë e pandare të DST.

Në cdo rast nëse janë përmendur marke prodhimi ose proces i vecante pranohen edhe ekuivalent.

ARGUMENTIMI I KRITEREVE PËRZGJEDHËS PËR KUALIFIKIM

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

1. Çmimi	pikët 70
2. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet)	pikët 10
3. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)	pikët 15
4. Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)	pikët 5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0 - 70] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

2. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

P_{k3}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k3}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k3}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k3}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

3. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)

[0 - 15 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- *Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.*

- Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$$

P_{k4}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k4}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k4}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k4}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohej nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë garancinë sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

4. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %) [0 - 5 pikë]

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë ofertën për vlerën PSK në rubriken specifike/zerin “Siguria në kantier (Plani I Sigurisë e Kordinimit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, datë 13.04.2023)”, në preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posaçme edhe me përmbytjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të veçantë për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbytshen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e veçantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet në Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrike në masën jo më pak se 3%, përlogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas përcaktimeve të VKM nr. 216 datë 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast jo më pak se 3,651,750.19 leke pa tvsh. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, Aneksi VI “Përmbytja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e te levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do te konsiderohet vlere e ofertuar nga operatori ekonomik per zerin Siguria ne kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit te shtuar), e perfshire ne oferten ekonomike te detajuar, konkretisht sipas Shtojces 2 te DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”

- Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlere 3,651,750.19 leke pa tvsh.
- Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlere 3,651,750.19 leke pa tvsh, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)
- Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlere PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlere 3,651,750.19 leke pa tvsh, do të vlerësohet si më poshtë:

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} / V_{\max k5} \times P_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet
 $V_{\max k5}$ Vlere më e lartë e kriterit që vlerësohet
 $P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
 O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)”, kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlere së kërkuar.

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia ne punime: siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social” nëse vlere e saj do të jetë më shume se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O – (pikët e Ofertës)
 Mo – Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme
 N – Numri i ofertave të vlefshme
 PR (R_{rm}) – Rritje e mundshme
 $Mo = O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n / N$
 $PR = 200 \% Mo$

Vlere e ofertave të ofruara > PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përlllogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK (200% MO = 51,500,000 leke < 55,000,000 leke) dhe vleresohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlere per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlere korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Projekti teknik, Specifikimet teknike, raportet teknike, preventivi me zerrat e punimeve, grafiku janë hartuar nga subjekt projektues të licencuar dhe jane pjese e DST.

Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante ne kete procedure prokurimi do te pranohen edhe ekuivalent

Gjithashtu edhe nese tek specifikimet teknike AK i është referuar vetëm standarteve europiane: “EN...” Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane.